



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL ¹

(I përmbledhur)

Tiranë, më 22.02.2019, ora 10.00

Drejton mbledhjen -

Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit

Rendi i Ditës :

1. Diskutimi në parim të Projektvendimit për procedurat e verifikimit të kandidatëve për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

2. Informacion mbi gjendjen e sistemit të administrimit të çështjeve në Gjykatën e lartë lidhur me mundësinë që e realizimit me këtë sistem të shortit elektronik për caktimin e ratorëve të vendeve vakante.

Marrin pjesë² :

- | | |
|--------------------------|------------------------|
| 1. Ardian Dvorani | (kryetar) |
| 2. Vitore Tusha | (zëvendës kryetare) |
| 3. Arta Marku | (anëtare) |
| 4. Fatri Islamaj | (anëtar) |
| 5. Margarita Buhali | (anëtare) |
| 6. Eriol Roshi | (anëtar) |
| 7. Klodiana Veizi (Mema) | (anëtare zëvendësuese) |
| 8. Gurali Brahimllari | (anëtar zëvendësues) |

¹Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funksionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike diskutimet e vetë anëtarëve të KED për çështjen e rendit të ditës, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të fituara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

²Anëtarja e Fatjona Memçaj nuk merr pjesë në diskutimin dhe miratimin e akteve nënligjore normative, për shkak të papajtueshmërisë-marrëdhënie krushqie e afërt me kandidaten Ardita Alsula. Sipas ligjit, Kryetari i Këshillit e ka miratuar heqjen dorë me vendimin nr.1 datë 14.02.2019.

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :

1. Nejla Peka, Komisionere pranë Avokatit të Popullit, si përfaqësuese e autorizuar e Avokates së Popullit zonjës Erinda Ballanca, për mbledhjen e KED-së të datës 22.02.2019 .

Merr pjesë, si i ftuar, nga përfaqësuesit e subjekteve të treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016 :

1. Ulsi Manja, kryetar i Komisionit të Përhershëm Parlamentar “Për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut” në Kuvend.

Merr pjesë, si e ftuar, përfaqësuese nga institucionet ndërkombëtare, mbështetëse të procesit të hartimit të akteve nënligjore të KED :

1. Julinda Beqiraj, eksperte pranë EURALIUS.

HAPET MBLEDHJA

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, deklaron të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

Informohet Këshilli se mungon anëtari zëvendësues Medi Bici, për shkak të angazhimit në një veprimtari të Këshillit të Lartë Gjyqësor në të cilin ai ushtron funksionin e anëtarit të atij institucioni.

Ardian Dvorani lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

1. *Diskutimi në parim të Projektvendimit për procedurat e verifikimit të kandidatëve për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.*

2. *Informacion mbi gjendjen e sistemit të administrimit të çështjeve në Gjykatën e lartë lidhur me mundësinë që e realizimit me këtë sistem të shortit elektronik për caktimin e ratorëve të vendeve vakante.*

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

Anëtarët e Këshillit miratojnë pa ndryshime dhe shtesa të tjera rendin e ditës.

Anëtarët e Këshillit zhvillojnë diskutimin në parim lidhur me projektaktin normativ “Për procedurat e verifikimit të kandidatëve për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë”, e në veçanti lidhur me disa çështje të natyrës parimore që kanë të bëjnë me :

(1) *Procedurat standarde të verifikimit, pavarësisht nga elementët përbërës të verifikimit, mbi të gjitha, me synimin e garantimit të procesit të rregullt ligjor dhe të transparencës në verifikimin e kandidaturës.*

(2) *Përparësitë e kryerjes së procedurave të verifikimit njëkohësisht për të gjitha elementët, kriteret dhe kushtet që lejojnë/ndalojnë kandidimin, ndërsa vendimmarrja e KED mund të ndodhë edhe për secilin prej tyre nëse rezulton që mund të jetë rasti për të disponuar ndalimin e kandidimit sipas ligjit, pa nevojën e përfundimit të procesit të verifikimit për të gjitha këto kushte ligjore të kandidimit.*

(3) *Nevoja për të përcaktuar një afat për kryerjen ose jo të procedurës së verifikimit të pasurisë, nëse për shkak të funksioneve publike që kryen, kandidati i nënshtrohet periodikisht deklaramit të pasurisë.*

(4) *Nevoja për verifikim ose jo nga KED të kandidatëve që janë magistratë të cilët i janë nënshtroar apo po i nënshtrohen procesit të rivlerësimit kalimtar. Në rastin e atyre që i janë nënshtroar tashmë, për cilin afat do të konsiderohet i panevojshëm verifikimi i tyre, duke vijuar vetëm me verifikimin e kushteve të tjera ligjore që janë specifike për efekt të kandidimit.*

(5) *Rregullat që duhet të përcaktohen për relatorin që duhet të procedojë me verifikimin në rastet e kandidimeve njëkohësisht në më shumë se një pozicion vakant.*

Ulsi Manja, në lidhje me diskutimin e këtyre çështjeve parimore që u zhvillua mes anëtarëve të Këshillit, kërkon fjalën dhe parashtrohet se për verifikimin e pasurisë ligji i ngarkon Këshillit dy detyra, të pajisë kandidatët me formularë e deklaramit dhe e dyta të njoftojë ILDKPI-në me shkresë zyrtare kush janë kandidatët e kur janë paraqitur dhe pajisur me këto formularë. Ndërsa ligji për kontrollin dhe deklarimin e pasurive i ka të përcaktuara qartë, me ndryshimet e fundit që i janë bërë, se kur kanë kaluar 180 ditë kryhet kontroll i ri i thelluar, por është marrëdhënia e kandidatit me ILDKPI-në që ua përcjell juve informacionin. Afat 180 ditë fillon nga momenti që kandidati dorëzon Deklaratën pranë ILDKPKI. Kjo e fundit njofton Këshillin se si ka vepruar me rastin konkret. Me ndryshimet e fundit të atij ligji kontrolli i thelluar është i detyrueshëm për të gjithë subjektet. Ndërkohe KED nuk ka asnjë pengesë ligjore ti drejtohet çdo institucioni për verifikimin e pasurisë dhe nëse e vlerëson ta analizojë informacionin e ardhur për pasurinë.

Nejla Peka, në lidhje me diskutimin e këtyre çështjeve parimore që u zhvillua mes anëtarëve të Këshillit, kërkon fjalën dhe parashtrohet se lidhur me momentin e kandidimit në kushtet kur ka kaluar një kohë shumë e gjatë nga kandidimi, kur shpreh interesin beson se i plotëson kriteret, referuar kushteve ligjore të parashikuara në ligj në momentin që shpreh

interesin. Nëse rishpallet gara atëherë i referohemi plotësimit të kushteve ligjore në kohën e rishpalljes. Ndërsa në rastin e vlerësimit, siç janë kriteret që pikëzohen në nenin 240 të ligjit duhet të jetë në tagrin e Këshillit të kryejë vlerësimin me kriteret që janë plotësuar jo vetëm në kohën e kandidimit por edhe nëse ato janë plotësuar gjatë kohës së pritjes për shqyrtim të kandidaturave, kohë e cila nuk varet nga kandidati, si psh kriteret e titujve akademikë etj.

Lidhur me realizimin e analizës financiare me anë të një eksperti do të ishte një veprim i vlefshëm, por për të lehtësuar punën e relatorit dhe të Këshillit në kryerjen e një hetimi të thelluar, duhet të përcaktohet se për çfarëloj eksperti bëhet fjalë, për ekspert kontabël të autorizuar, audit apo diçka tjetër, si edhe kur duhet të përdoret eksperti.

Në këtë projektvendim normativ duhet të bëhet kujdes për sa i përket terminologjisë që duhet të përdoret duke filluar që nga titulli dhe më tej në dispozitat e tij, duke pasur parasysh ato që parashikon vetë ligji nr.115/2016. Sipas ligjit qëllimi kryesor i KED-së është të kryejë renditjen e kandidatëve bazuar në procesin e verifikimit paraprak të kushteve ligjore dhe të kushteve nënligjore.

Pas diskutimit të të gjitha çështjeve parimore, anëtarët e Këshillit, në parim, erdhën në përfundimet se :

(1) do të parashikohen dhe përgatiten procedura dhe dokumente standarde për verifikimin e kandidatëve, përveç veprimeve të tjera shtesa që do të vlerësojnë rast pas rasti gjatë verifikimit të kandidatit relatorët e vendeve vakante apo mbledhja e Këshillit;

(2) procedurat e verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore nga kandidatët do të kryhen njëkohësisht për të gjitha elementët, kriteret dhe kushtet që lejojnë/ndalojnë kandidimin. Nëse relatorët vlerësojnë se nga veprimet e verifikimit ka gjetje që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, do të propozojnë mbledhjes së Këshillit të shqyrtojë rastin bazuar në këto gjetje pa nevojën e përfundimit të procesit të verifikimit për të gjitha kushtet ligjore të kandidimit.

(3) për verifikimin e pasurisë kandidatët do të pajisen nga Këshilli me formularin e Deklarimit dhe është detyrim i tyre të paraqitën brenda afatit ligjor 15 ditor pranë ILDKPKI. Këshilli do të njoftojë ILDKPKI për listën e kandidatëve të paraqitur dhe kohën kur janë paraqitur. Për kandidatët gjyqtarë që i janë nënshtruar rivlerësimit kalimtar dhe atyre që i nënshtrohen rregullisht kontrollit periodik dhe atij të thelluar, do të jetë në kompetencën e ILDKPKI të vlerësojë nëse do të kryejë verifikimin e pasurisë ose jo, për rastin e afatit 180 ditor nga ai i kontrollit të funit të thelluar etj.

(4) për kandidatët magistratë që po i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar, KED nuk do të kryejë veprime verifikuese por do të presë dhe mbështetet në gjetjet

dhe përfundimet e organeve të rivlerësimit kalimtar, ndërkohë që KED do të kryejë verifikimin e plotësimit të kushteve të tjera ligjore të kandidimit të cilat nuk janë në objektin e hetimit dhe disponimit nga organet e vetting-ut. Për ata që kanë kaluar në këtë proces, do të vlerësojë ILDKPKI nëse duhet të rikontrullohen dhe nëse janë përtej afatit 180 ditor nga ai i vendimi të dhënë nga rohani i rivlerësimit kalimtar

(5) Për rastet e kandidatëve që janë kandiduar në më shumë se një vend vakant njëkohësisht në proces verifikimi dhe vlerësimi nga Këshilli, secili relator i vendeve vakante kryen veprimet e tij/saj verifikuese duke i paraqitur mbledhjes së Këshillit propozimet përkatëse. Ndërkohë relatorët do të kryejnë bashkërisht pjesën e veprimeve verifikuese standarde për të gjithë kandidatët, duke vlerësuar secili më tje nëse ka nevojë për verime të tjera verifikuese, si edhe për propozimet që çmojnë ti bëjnë mbledhjes së Këshillit

Anëtarët e Këshillit dhe pjesëmarrësit e tjerë diskutojnë mbi raportin teknik të paraqitur nga sektori IT i Gjykatës së Lartë, në lidhje me çështjen e mundësisë së realizimit të shortit elektronik nëpërmjet përdorimit të sistemit të administrimit të çështjeve të Gjykatës së Lartë.

Anëtarët e Këshillit konstatuan se sipas raportit teknik sistemi elektronik i administrimit të çështjeve në Gjykatën e Lartë për vetë programimin dhe elementët teknikë të tij nuk mund të realizojë veprime jashtë atyre të natyrës gjyqësore, prandaj edhe erdhën në përfundimin që në momemntin kur do të hidhet shorti për caktimin e relatorëve për vendet vakante, Këshilli të shqyrtojë dhe vendosë për mënyrën e realizimit të shortit.

Pas konsultimit me **anëtarët e Këshillit** dhe dakordësisë për caktimin e mbledhjes së radhës në datën 01.03.2019 ora 13.00 për të vijuar me diskutimin e miratimin nen për nen të dispozitave të projektaktit normativ “Për procedurat e verifikimit të kandidatëve për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë”, **Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani** e deklaroi të mbyllur mbledhjen.

MBLEDHJA MBYLLET ME ORËN 12.20.

Sekretare

Kryetari

Redjona MYRTJA

Ardian DVORANI

Ermelinda KADIU

Dorina DULAJ

